REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/2483
Nr. Fag.
Data 08/05/2020

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/11/20
Datë:07.05. 2020

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12, paragrafi 12.2, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 21, paragrafi 21.1 pika j) Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.04.2020, mori këtë:

VENDIM

për fillimin e hartimit të (projekt) Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale

I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale / në tekstin e mëtejme (projekt) Rregullorja/.

II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

III. Bartëse e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartoj në afat prej 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

V. Autorizohet Kryetari i Komunës se Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta emëroj grupin punues për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi.

VI. (projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.

VII. Pas hartimit (projekt) Rregullorja i procedohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anë të të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i komunës së Junikut
- Ministria e Financave,
- Shërbimi i Kuvendit,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/MUNICIPALITY OF JUNIK
KRYESUESI I KUVENDIT/PRESIDENT OF THE MUNICIPAL ASSEMBLY
JUNIK